| 12 | | **Çështja A8**<br>**- Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV**<br>Gjetja Rregulla MF Nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor të OB-ve, Neni 6 - Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore thekson se OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Derisa neni 10, përcakton Strukturën e PFV-ve, dhe ndër të tjera potencon që detyrimet kontigjente janë pjesë e PFV-ve. Vlera e detyrimeve kontingjente, e shpalosur në PFV të vitit 2021 ishte 257,325€ derisa do të duhej të ishte 169,440€. Nga kjo, një faturë në vlerë 87,885€ ishte përfshirë gabimisht në regjistrin e detyrimeve kontigjente por edhe në regjistrin e faturave të papaguara. Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve në krahasimin dhe verifikimin e regjistrave të detyrimeve kontigjente dhe regjistrin e faturave të papaguara.<br>Ndikimi - Mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente shkakton mbivlerësim të tyre dhe mund të ndikojë në vendimet e shfrytëzuesve të informatave të shpalosura në PFV. | Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së PFV-ve të rishikohen regjstrat e detyrimeve kontingjente dhe detyrimeve/faturave të pa paguara në mënyrë që të shmangen dyfishimet e mundshme dhe informatat të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV. | Do të angazhohemi që në fund vit të mos regjistrohen si detyrime kontigjente dhe të njëjtën kohë ai kontest gjyqësor të regjistrohet si obligim i pa paguar deri më 31.12. i vitit të raportimit. | Avokati publik , Drejtori i DFEZH dhe zyrtarëtë financav e ( arhivimi i faturave ). |
| 13 | | **Çështja A9**<br>**- Mangësi në Sistemin e Auditimit të Brendshëm**<br>Gjetja Në planin vjetor të auditimit ishte paraparë që auditimet e planifikuara të kenë fushëveprim aktivitetet e vitit 2020 dhe pjesërisht aktivitetet e vitit 2021. Derisa sipas Procedurës Standarde të Operimit "Trajtimi i të Gjeturave dhe Zbatimi i Rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm dhe të Brendshëm" të miratuar nga Ministria e Financave, kërkohet që për rekomandimet e dhëna nga NjAB duhet të përgatitet një plan veprimi për zbatimin e tyre, dhe ai plan duhet të monitorohet. Përveç kësaj, neni 8 i Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për Themelimin dhe Funsionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, përcakton që KA duhet të mbajë së paku katër (4) takime Brenda vitit. NjAB | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme për NjAB-në në mënyrë qe planet e auditimit të realizohet në tërësi dhe auditimet të përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Çdo raport i | Plani ynë i veprimit do të jetë ky :<br>-Do të kërkojmë nga Kryetari i Komunës që të siguroi burime të mjaftueshme të stafit për NJAB , në mënyrë që të realizohet Plani vjetor i Aditimit të brendshëm. | Auditori i mbrends hëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nuk e ka përmbushur planin vjetor të auditimit pasiqë vetëm dy (2) nga pesë (5) auditimet e planifikuara janë realizuar gjatë vitit 2021. Auditimet e realizuara mbulojnë aktivitetet e prokurimit si dhe të departamentit të tatimit në pronë vetëm për vitin 2020. Nga 9 rekomandimet e dhëna nga NjAB gjatë vitit 2021, vetëm tre (3) janë zbatuar, dy (2) ishin në proces të zbatimit dhe katër (4) tjera nuk ishin adresuar. Derisa KA kishte mbajtur vetëm një (1) takim gjatë vitit 2021. Mos përmbushja e planit ka ndodhur si pasojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm në kuadër të NjAB-së pasiqë Drejtori i njësisë është pensionuar dhe njësia ka mbetur me vetëm një Auditor, derisa mos adresimi i rekomandimeve ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së stafit të përfshirë në departamentet e audituara. Ndërsa, për shkak të neglizhencës dhe paqartësisë në lidhje me kompensimin e anëtarëve për angazhim në Komitetin e Auditimit (KA), nuk kishte aktivitete konform udhëzimit administrativ.<br>Ndikimi - Mos përmbushja e planit të auditimit dhe mos përfshirja e aktiviteteve të vitit aktual në auditim mund të ndikojë që mangësitë eventuale të mos identifikohen dhe adresohen me kohë nga menaxhmenti i Komunës. Mos përgatitja e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve e vështirëson përcjelljen e tyre dhe vlerësimin nëse ato rekomandime po zbatohen. Derisa mos mbajtja e takimeve të rregullta të KA, ndikojnë në mos harmonizimin e veprimeve ndërmjet Kryetarit, NjAB-së dhe departamenteve të audituara në lidhje me çështjet e identifikuara nga auditimi. | auditimit të brendshëm duhet të pasohet me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe i njëjti të monitorohet në baza të rregullta kohore. Po ashtu KA duhet ti mbajë me rregull takimet në mënyrë që të ofrojë kontributin e tij konform obligimeve të përcaktuara me rregullat në fuqi. | -Do të insistojmë nga çdo subjekt i audituar që çdo Raport i auditimit të brendshëm të pasohet me Plan të veprimit të menaxhmentit , për zbatimin e rekomandimeve.<br>-Do të kërkojmë nga Kryetari i Komunës që ta obligoi KAB-in që ti mbaj takimet e rregullta , në mënyrë që të ofroi kontributin e ti sipas obligimeve të përcaktuara me rregullat në fuqi. | | | |

Janë marrë për bazë të gjitha rekomandimet e gjetura nga auditori i jashtëm, të gjithë akterët ka përgatitë planin e veprimit dhe do të ndërmerren aktivite për monitorimin sistematik të zbatimit të Planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna për zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe presim rezultate shumë më të mira në prezentimin e PVF 2022 sepse të gjithë akterët (punonjësit ) me të gjeturat e Auditorit të jashtëm janë njoftuar, duhet të jenë të përkushtuar që lëshimet e gjetura të mos përsëriten në prezentimin e PVF 2022.

Viti

28.06.2022

Kryetari i Komunës :

Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E VITISË OPŠTINA VITINA DREJTORIA PËR FINANCA EKONOMI DHE ZHVILLIM UPRAVA ZA BUDJET PRIVREDU I RAZVOJ

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
06-09-2022
02-052/01-985

**Komuna e Vitisë**

**Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim**

**Informatë lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31.12.2021**

**Duke u bazuar në Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjsitë Ligji Nr. 03/L-048 ( plotësim ndryshimet në Ligjin Nr,03/L-221 ,Ligjin nr.04/L-116, Ligjin nr .04/L-194, Ligjin nr .05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007 ) Neni 45 dhe neni 46 ( neni 46 paragrafi 46.2) që obligojnë organizatat buxhetore të përgatisin Raporte tremujore respektivisht raport përfundimtar për vitin e kaluar kalendarik.**

**Mandej duke u bazuar në Rregullore MF-NR.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga organizatat buxhetore – Neni 4 obligimet e raportimit të organizatave buxhetore ( Organizatat Buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të dorëzojnë Pasqyrat Vjetore Financare në MF-Departamentin e thesarit , Neni 5 afatet kohore për dorëzimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dorëzohen brenda afatit prej 30 ditë nga përfundimi i vitit fiskal në formë të shtypur dhe në formën elektronike.**

**Ne si drejtori ju kemi përmbajtur Ligjit dhe rregullores në fuqi dhe i kemi përgatitur duke u bazuar në regjistrin kontabël të thesarit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik e dorëzuar në kohë më 30.01.2020 .**

**Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin e përfunduar Janar- Dhjetor 2021 e ka kryer „ Zyra Kombëtare e Auditimit„ ka filluar auditimin në muajin në muajin dhjetor 5 ditë pune dhe në muajin mars 15 ditë pune ( auditori i ZKA-së Bujar Bajraktari udhëheqës i ekipit, Gazmend Namani anëtar i ekipit , Edon Kqabashi- anëtar i ekipit dhe Fatbardha Jashari anëtare e ekipit, nën menagjimin e drejtorit të auditimit Lavdim Maxhuni .**
**Zyra e kombëtare e auditimit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar , kryen auditime të rregullsis dhe të performancës, që është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Instirucioneve Supreme të Auditimit (SNAISA ).**

**Misioni i ZKA-së është që të kontribojmë në menagjim të shëndosh financiar në administratën publike , ndërton besim në shpenzimin e fondeve publike dhe luajnë një rol aktiv për rritje të llagaridhënjes së institucioneve publike .**

**Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e RVF për vitin 2021 i cili e përcakton OPINIONIN e dhënë nga auditori i përgjithshëm i cili pasqyron drejt për së drejti cilësin e kontrollit të mbrendshën të përcaktuar nga menagjmenti.**

| Auditori është fokusuar në : |
| --- |
| PVF - Menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe rekomandimet e vitit paraprak |

OPINIONI – është një pasqyrim i të gjeturave të audituara

## Format e Opinionit ( vlerësimit) janë si :

**Opinion i pamodifikuar - auditori jep këtë opinion nëse vjen në përfundim se pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.**
Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keqdeklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keqdeklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

**Por nëse ka të gjetura që nuk pasqyrojnë anomali materiale atëher ipet vlerësimi opinion i i pakualifikuar me theksim gjetjesh që për të tërhequr vëmendjen për çështjen e theksuar me rekomadim të përmirësimi gjat përgatitjes së PVF në vitin e ardhshëm .**

**Opinion i modifikuar - nëse pasqyrat financiare nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë atëher jepet vlerësimi i modifikuar- i zavendësuar me kualifikim të kualifikuar .**
Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit
Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri:
Opinioni i modifikuar mund të jetë:
- I kualifikuar,
- I kundërt, ose

- Mohim opinion

**Opinioni i kualifikuar** - Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinion i kundërt** - Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

**Mohim i opinionit** - Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, kur në dëshmit e marra të auditimit arrin në përfundim se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë gabime materiale ose nuk ka mund të marr dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme ,ku auditori vjen në përfundim se efektet e çdo gabimi të pa zbuluar mund të jenë materiale , nuk ka material bazë pë të vlerësuart fare .

## Opinioni i auditorit për PVF për vitin e përfunduar 31.12.2021

**Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë .**

**Opinioni i audititorit „ OPINION I PAMODIFIKUAR PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE“**

**Bazë për këtë opinion :**

**Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Vitisë për vitin 2021 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për sektorin publik sipas kontabbilitetit të paras së gatshme.**

**Auditimin është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Intitucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjsit tona janë përshkruar te pjesa e raportit„**

**përgjegjsit e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" në në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e etikës së ZKA-së si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatës buxhetore . Besojmë se dëshmit e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës pë opinion.**

## Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

**Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Vitisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare ( shënim i auditorit).**

Gjatë auditimit, janë vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, subvencionet, mos respektimi i procedurave të prokurimit, hyrja në obligime pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve, të arkëtueshmet, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, si dhe pasuritë jo financiare, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre nëntë (9) janë rekomandime të reja, tri (3) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht e përsëritur.

**Menagjmenti i komunës ka projektuar dhe zbatuar një sistem të kontrolleve të mbrendshme por disa kontrolle të administrimit nuk operojnë në mënyrë efektive duke identifikuar këto rekomandime dhe Kryetari duhet të siguroj për të gjeturat :**

**Çështja 1 - Përfitimi i paligjshëm i tatimpaguesve i Zbritjes për Vendbanim Parësor**

**Gjetja**: Ligji Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 11, Zbritja për Vendbanimin Parësor, midis tjerash përcakton se personi fizik i cil ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mundet vetëm njërën prej këtyre objekteve ta deklarojë si vendbanim të ti parësor, me që rast i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë eurove (15,000 €) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Gjatë analizës së Bazës së Dhënave të tatimit në pronë, janë identifikuar së paku nëntë (9) raste të tatimpaguesve të cilët kanë të evidentuar si vendbanim të tyre parësor dy e më shumë objekte banimi. Për më tepër, situata është më serioze sepse më shumë se 1,000 tatimpagues të prezantuar në këtë Bazë të të dhënave nuk kanë të

prezantuar numrat personal, të cilët potencialisht mund të jenë përfitues të disahershëm nga zbritja e lejuar ligjore. Kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesis së zyrtarëve dhe mangësive të sistemit që lejon përfitimin e disahershëm të tatimpaguesve dhe të futjes së tyre në sistem pa numër identifikues.

**Ndikimi:** Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

**Rekomandimi:** Kryetari dhe vartësit e tij duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për identifikimin e të gjithë përfituesve të disahershëm të zbritjes së vendbanimit parësor, t'i korrigjojnë të dhënat në sistem dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat ligjore, për eliminimin e këtij problemi.

**Çështja 2 - Subvencionimi i përfituesve në kundërshtim me Rregulloren Komunale dhe Rregulloren e Financimit Publik të OJQ-ve**

**Gjetja:** Rregullorja Komunale e Subvencioneve, Nenet 6, 13 dhe 23 përcaktojnë se personi fizik apo juridik mund të përfitojë subvencione nga Komun vetëm një herë në vit dhe me rastin e subvencionimit duhet të lidhet marrëveshje e cila përcakton të drejtat dhe obligimet e Komunës dhe përfituesit, si dh raportimin financiar dhe narrativ nga përfituesi. Ndërsa, Rregullorja për Financimin Publik të OJQ-ve përcakton se dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohe nga çdo Organizatë Buxhetore, me përjashtim të mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë për OJQ-të, e cila nuk tejkalon shumën prej 500€ për një OJC Komuna kishte subvencionuar një OJQ dy herë me nga 2,000€, dhe atë pa shpallur Thirrje Publike por vetëm me vendim të Kryetarit. Kjo është n kundërshtim me Rregulloren Komunale për Subvencionet si dhe Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve. Kjo ka ndodhur për shkak të mos zbatim konsistent të kërkesave të rregulloreve në fjalë.

**Ndikimi:** Dhënia e subvencioneve për përfituesit e njëjtë më shumë se një herë, i privon përfituesit tjerë që të përfitojnë subvencione të paktën një her brenda vitit. Ndërsa, duke mos shpallur thirrje publike, anashkalohen parimet e konkurueshmërisë, trajtimit të barabartë, transparencës, llogaridhënies, dh raportimit mbi shfrytëzimin e fondeve publike nga përfituesi i subvencionit, pasi që mungojnë Marrëveshjet midis Komunës dhe përfituesit në lidhje m kushtet e shpenzimit të fondeve, dhe mënyrën e raportimit.

**Rekomandimi:** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që përfituesit të përfitojnë subvencione vetëm njëherë brenda vitit ashtu siç është përcaktuar m rregullore. Ndërsa për çdo subvencionim të OJQ-ve që kualifikohet për t'u trajtuar sipas Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve, të shpallet Thirrj Publike dhe të aplikohen kërkesat që rrjedhin nga e njëjta.

**Çështja 3 - Mangësi në përmbylljen e procedurave të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratave**

**Gjetja:** Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik (RrUOPP), paragrafi 61.4 përcakton që pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ "ZKA". ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike dhe një mbikqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës. Më tutje paragrafi 8.7 i RrUOPP përcakton që personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit të Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale. Te kontrata ''Rregullimi i fushave sportive në Komunën e Vitisë'' në vlerë 424,176€, ZKA kishte emëruar menaxherin e kontratës, por jo edhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës, Zotimi i mjeteve është bërë në vlerë 50,000€, edhe atë pas nënshkrimit të kontratës (kontrata ishte nënshkruar me 11.05.2021 ndërsa zotimi me 14.05.2021), derisa për vitin 2021 ishin parashikuar të shpenzohen 170,000€. Te kontrata ''Ndërtimi i urave në fshatin Pozheran dhe Buzovik'' në vlerë 74,888€, rishqyrtimi i disponueshmërisë së fondeve ishte bërë në datën e njoftimit për kontratë e jo para njoftimit për dhënie. Po ashtu nuk është bërë zotimi i mjeteve para nënshkrimit të kontratës. Te kontrata ''Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik'' në vlerë 820,153€, disponueshmëria e fondeve është nënshkruar dhe rishqyrtuar nga personat përgjegjës, por zotimi i mjeteve para nënshkrimit të kontratës është bërë në vlerë vetëm 50,000€, derisa buxheti për vitin 2021 ishte 370,000€. Shpenzimet për këtë projekt në vitin 2021 ishin 97,493€. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit korrekt të kërkesave ligjore.

**Ndikimi** : Mos respektimi i kërkesave në lidhje me disponueshmërinë e fondeve dhe zotimin e mjeteve para nënshkrimit të kontratave, mund të ndikojë në hyrjen në obligime pa pasur mjete të mjaftueshme në dispozicion dhe të krijojë vështrësi në realizimin e projekteve.
**Rekomandimi:** Kryetari duhet të sigurojë që të zbatohen me përpikëri kërkesat ligjore në lidhje me disponueshmërinë dhe zotimin e fondeve, përgjatë procesit të zhvillimit dhe përmbylljes së procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave.

## Çështja 4 - Vonesa në pagesën e faturave/obligimeve dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbarimore

**Gjetja:** Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për LMFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi. Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se Komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 182,941€ apo 1,224 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor për pagesë. Këto pagesa kanë të bëjnë kryesisht me mallra dhe shërbime. Vonesat variojnë nga një (1) muaj deri në 2.5 vite. Për 11 pagesa për mallra dhe shërbime, të cila ishin realizuar direkt nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore në vlerë 28,323€, borxhi kryesor ishte 22,265€ ndërsa 6,058€ tjera ishin për shpenzime procedurale të gjykatës/përmbarimit. Përveq kësaj Thesari si rezultat i vendimeve të përmbarimit/gjykatave ka ekzekutuar pagesa për paga jubilare dhe përcjellëse në vlerë prej 892,822€. Komuna nuk ka informata se sa nga këto mjete ishin për borgjin kryesor e sa për procedura dhe kamata. Mos pagesa e obligimeve me kohë sa i përket pagave ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve për shlyerjen e obligimeve të dalura nga kontrata kolektive, derisa tek faturat e paguara me vonesë ka ndikuar pjesërisht ardhja e faturave me vonesë në fundvit dhe vonesat në zotimin e mjeteve në vitin pasues, dhe pjesërisht mos dërgimi i faturave me kohë nga departamentet tjera në departamentin e financave.
**Ndikimi:** Mos pagesa e faturave dhe obligimeve me kohë e ekspozon Komunën ndaj padive të mundshme nga Operatorët Ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë për procedura gjyqësore/përmbarimore si dhe shpenzime të kamatave. Kjo po ashtu, ndikon në planin e shpenzimeve dhe pamundëson arritjen e objektivave të përcaktuara.
**Rekomandimi:** Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit

## Çështja 5- Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa kryer procedurat adekuate ligjore

**Gjetja:** Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 thekson se - Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Derisa sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit. Komuna e Vitisë gjatë vitit 2021 kishte të angazhuar 79 zyrtarë me kontrata për shërbime të veçanta, dhe për këto angazhime Komuna kishte zhvilluar procedurat të rekrutimit sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Rastet e analizuara për këto angazhime, pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik, kemi vërejtur se, kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik. Shumica nga këta zyrtar punojnë në pozita të rregullta të punës si: në drejtorinë për financa, administratë, prokurim, gjeodezi dhe kadastër, arsim, shëndetësi etj. Të njëjtit janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (përfshirë edhe kontributet pensionale dhe tatimin në pagë). Angazhimi i punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta sipas pohimeve të menaxhmentit ishte bërë si pasojë e mungesës së numrit të pozitave të aprovuara në Ligjin e Buxhetit.
**Ndikimi:** Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu, rritë rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancën e tyre në punë.

**Rekomandimi**: Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit për angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Pozitat e rregullta duhet të planifikoh me Ligjin e Buxhetit dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

## Çështja 6 - Mangësi në inspektimin e objekteve komunale

**Gjetja**: Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 15, përcakton se Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektorë privat. Gjatë shqyrtim të inspektimeve të bëra nga Komuna, janë vërejtur përpjekje domethënëse për inspektimin e pronave, ku anketuesit kanë arritur të inspektojnë 2,006 objekte apo rreth 14%. Megjithatë nuk është arritur kuota e kërkuar ligjore prej 20%. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm për kryerjen e inspektimeve.

**Ndikimi**: Mos arritja e inspektimit të 20% të objekteve mund të rezultojë në ngarkesë të tepërt apo të pakët tatimore për tatimpaguesit, që në cilindo rast njëra palë potencialisht është e dëmtuar.

**Rekomandimi**: Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

## Çështja 7: - Vlerësimi i aplikacioneve për subvencione në kundërshtim me rregulloren

**Gjetja**: Te thirrja publike për aplikim për Inkubator për çeljen e zogjve, midis kritereve tjera janë përcaktuar edhe kriteret ku përparësi kanë: familjet me gjendje të rëndë ekonomike, kryefamiljaret femra, fermerët që kanë traditë në këtë veprimtari, fermerët të cilët jetojnë në fshatrat më të larta malore, fermerët te cilët kanë kushte të favorshme për vendosjen e Inkubatorit. Ndërsa te Thirrja Publike për aplikim për Serra midis kritereve tjera janë përcaktuar edhe kriteret ku përparësi kanë: fermerët femra, gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime etj.

Ndërsa, Rregullorja e Komunës për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Neni 8, përcakton se Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve pas përfundimit të afatit të Shpalljes Publike, për të cilin proces mban edhe procesverbal, dhe me shumicë të votave ia rekomandon Kryetarit listën e përfituesve.

Gjatë analizimit të 11 aplikacioneve që kanë qenë pjesë e këtyre dy thirrjeve publike, kemi gjetur se komisioni i vlerësimit përveç që nuk ka ofruar dëshm të shkruara në lidhje me vlerësimin aplikacioneve, nuk ka mbajtur as procesverbale për ta kuptuar se si ka ardhur deri tek përzgjedhja e përfituesve të subvencionit dhe eliminimit të tjerëve.

Për më tepër, pesë nga këta 11 aplikues janë eliminuar nga procesi i subvencionimit, por sa i përket dëshmive të gjithë kanë ofruar dëshmi të njëjta, dhe është e vështirë të vlerësohet se në bazë të çfarë kritereve është bërë përzgjedhja.

Komisioni i vlerësimit pohon se nuk kanë qenë në dijeni se është dashur të përgatitet formular i vlerësimit dhe të mbahen procesverbale.

**Ndikimi**: Subvencionimi i fermerëve duke mos respektuar kriteret e shpallura në Thirrje Publike dhe mungesa e të dhënave të shkruara në lidhje me ecurinë e procesit të vlerësimit, shfaqë paqartësi tek aplikuesit në lidhje me tërë procesin. Njëkohësisht kjo mund të ndikoj në eliminimin e përfituesve potencial të subvencionit.

**Rekomandimi**: Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se vartësit e tij që janë pjesë e komisioneve të vlerësimit, me rastin e vlerësimit të aplikacioneve fillimisht duhet t'u përmbahen kritereve të shpallura në thirrje publike, si dhe të respektojnë të gjitha kërkesat e aplikueshme të përcaktuara me Rregullore komunale të subvencioneve.

### Çështja 8 - Skadimi i sigurisë së tenderit para nënshkrimit të kontratës

**Gjetja:** Sipas paragrafit 31 pika 3 të RrUOPP-së - Validiteti i Tenderit, specifikohet se "Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës". Te kontrata "Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliç-Kaqanik" Faza e dytë, në vlerë 1,952 821€, për shkak të zgjatjes së procedurave, siguria e tenderit kishte skadua rreth dy javë para nënshkrimit të kontratës dhe Komuna nuk ka kërkuar rikonfirmimin apo zgjatjen e vlefshmërisë/sigurisë së tenderit. Kjo ka ndodhur p shkak të kontrolleve jo adekuate me rastin e përmbylljes të procedurës së prokurimit.

**Ndikimi:** Mungesa e vlefshmërisë së sigurisë së tenderit mund të ndikoj që Operatori Ekonomik (OE) të tërhiqet nga oferta dhe të vie në dështimin e procedurave të prokurimit. Në këtë mënyrë edhe realizimi i projekteve me kohë mund të dështoj.

**Rekomandimi:** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që kohëzgjatja e sigurisë së tenderit në të gjitha rastet të jetë e vlefshme deri në nënshkrimin e kontratës. Në rastet kur nënshkrimi i kontratave vonohet, duhet të kërkohet nga OE që të zgjatet vlefshmëria e sigurisë së tenderit për aq kohë sa është e nevojshme.

### Çështja 9 - Regjistrimi i gabuar i pasurisë si Investime në vijim

**Gjetja:** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e invetarizimit etj. Artikuj të shumtë në regjistrin e pasurive (si renovime, rregullim dhe asfaltim i rrugëve, rregullim i hapësirave gjelbëruese etj) në regjistrin e pasurive janë të regjistruar si Investime në vijim, e të cilat do të duhej të ishin regjistruar si pasuri të shfrytëzueshme dhe të kalkulohet zhvlerësimi për to. Vetëm nga blerjet e vitit 2017 dhe 2018, ne kemi identifikuar se 32 artikuj në vlerë 700,327€ në regjistrin e pasurive janë të regjistruara si investime në vijim. Sipas Komunës, kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në pranimin teknik të projekteve si dhe për shkak të ndryshimit të stafit në pozitën e zyrtarit të pasurive.

**Ndikimi:** Mbetja e artikujve të caktuar në regjistrin e pasurive si Investime në vijim ndikon në mos zhvlerësimin e pasurive me kohë dhe mbivlerësimin potencial të vlerës së pasurive.

**Rekomandimi:** Kryetari duhet të sigurojë që janë rishikuar regjistrat e pasurive në mënyrë që të evidentohen të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si Investime në vijim e që janë të finalizuara si projekte dhe të pranuara teknikisht, të bëhen ndryshimet edhe në regjistrin kontabël në mënyrë që atyre pasurive tu ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara me rregullore.

### Çështja 10 - Mangësi procesin e inventarizimit të pasurive

**Gjetja:** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, ndër të tjera përcakton si kërkesë edhe procesin e invetarizimit të pasurive dhe harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurive, para përgatitjes së PFV-ve. Komuna nuk e kishte bërë harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrit të pasurive para përgatitjes së PFV-ve, dhe inventarizimi nuk ishte kryer në pajtim me kërkesat e rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive pasi nuk i ka përfshirë komplet pasuritë e Komunës. Kjo ka ndodhur nga mos zbatimi me konsistencë i kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive nga ana e komisionit të inventarizimit.

**Ndikimi:** Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël ndikon në mungesë të informatave të sakta në lidhje me gjendjen dhe vlerën e pasurive si dhe në prezantim jo të drejtë të informatave në PFV.

**Rekomandimi:** Kryetari duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive të kryhet në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël.

## Çështja 11 - Mungesa e veprimeve për mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshme

**Gjetja:** Ligji për Tatimin në Pronë, Neni 26, përcakton se Komuna dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencën për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove. Ndërsa, në kontratat e nënshkruara midis Komunës dhe shfrytëzuesve të pronave Komunale parashihet që pagesat për shfrytëzim të pronës Komunale të bëhen në baza mujore. Gjatë testimit të mostrave të Llogarive të arkëtueshme (Ll.A), në nëntë (9) lëndë për shfrytëzimin e pronave komunale, kemi gjetur se borxhi i papaguar ishte rreth 51,000 €, ndërsa 1 shtatë (7) mostra të tatimit në pronë, borxhi i papaguar ishte rreth 56,000€. Bazuar në vlerën e Ll.A dhe mostrave të testuara, vërehet se Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për mbledhjen e këtyre borxheve. Rritja e Ll.A ka ardhur si pasojë e mungesës së gatishmërisë së zyrtarëve komunal për ndërmarrjen e masave në dispozicion për të mbledhur këto borxhe.

**Ndikimi**: Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e të hyrave rezulton në uljen e të hyrave, kështu duke cenuar edhe realizimin e objektivave të planifikuara nga Komuna, si dhe rritë rrezikun që borxhet të vjetërsohen dhe të humbet mundësia e mbledhjes së tyre.

**Rekomandimi:** Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme dhe veprimet konkrete për mbledhjen e Ll.A, duke marrë në konsideratë çdo masë në dispozicion për mbledhjen e borxheve. Po ashtu, të merr masa të menjëhershme ndaj shfrytëzuesve të pronës komunale që nu paguajnë obligimet financiare duke kthyer pronat në përkujdesje të Komunës, në mënyrë që t'u jepet shfrytëzuesve të përgjegjshëm.

## Çështja 12 - Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV

**Gjetja**: Rregulla MF Nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor të OB-ve, Neni 6 - Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore thekson se OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Derisa neni 10, përcakton Strukturën e PFV-ve, dhe ndër të tjera potencon që detyrimet kontigjente janë pjesë e PFV-ve. Vlera e detyrimeve kontingjente, e shpalosur në PFV të vitit 2021 ishte 257,325€ derisa do të duhej të ishte 169,440€. Nga kjo, një faturë në vlerë 87,885€ ishte përfshirë gabimisht në regjistrin e detyrimeve kontigjente por edhe në regjistrin e faturave të papaguara. Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve në krahasimin dhe verifikimin e regjistrave të detyrimeve kontigjente dhe regjistrin e faturave të papaguara.

**Ndikimi:** Mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente shkakton mbivlerësim të tyre dhe mund të ndikojë në vendimet e shfrytëzuesve të informatave të shpalosura në PFV.

**Rekomandimi:** Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së PFV-ve të rishikohen regjstrat e detyrimeve kontingjente dhe detyrimeve/faturave të pa paguara në mënyrë që të shmangen dyfishimet e mundshme dhe informatat të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV.

## Çështja 13 - Mangësi në Sistemin e Auditimit të Brendshëm

**Gjetja:** Në planin vjetor të auditimit ishte paraparë që auditimet e planifikuara të kenë fushëveprim aktivitetet e vitit 2020 dhe pjesërisht aktivitetet e vitit 2021. Derisa sipas Procedurës Standarde të Operimit "Trajtimi i të Gjeturave dhe Zbatimi i Rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm dhe të Brendshëm" të miratuar nga Ministria e Financave, kërkohet që për rekomandimet e dhëna nga NjAB duhet të përgatitet një plan veprimi për zbatimin e tyre, dhe ai plan duhet të monitorohet. Përveç kësaj, neni 8 i Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për Themelimin dhe Funsionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, përcakton që KA duhet të mbajë së paku katër (4) takime Brenda vitit. NjAB nuk e ka përmbushur planin vjetor të auditimit pasiqë vetëm dy (2) nga pesë (5) auditimet e planifikuara janë realizuar gjatë vitit 2021. Auditimet e realizuara mbulojnë aktivitetet e prokurimit si dhe të departamentit të tatimit në pronë vetëm për vitin 2020. Nga 9 rekomandimet e dhëna nga NjAB gjatë vitit 2021, vetëm tre (3) janë zbatuar, dy (2) ishin në proces të zbatimit dhe katër (4) tjera nuk ishin adresuar. Derisa KA kishte mbajtur vetëm një (1) takim gjatë vitit 2021. Mos

përmbushja e planit ka ndodhur si pasojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm në kuadër të NjAB-së pasiqë Drejtori i njësisë është pensionuar dhe njësi ka mbetur me vetëm një Auditor, derisa mos adresimi i rekomandimeve ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së stafit të përfshirë në departamentet e audituara. Ndërsa, për shkak të neglizhencës dhe paqartësisë në lidhje me kompensimin e anëtarëve për angazhim në Komitetin e Auditimit (KA), nuk kishte aktivitete konform udhëzimit administrativ.

**Ndikimi:** Mos përmbushja e planit të auditimit dhe mos përfshirja e aktiviteteve të vitit aktual në auditim mund të ndikojë që mangësitë eventuale të mos identifikohen dhe adresohen me kohë nga menaxhmenti i Komunës. Mos përgatitja e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve e vështirëson përcjelljen e tyre dhe vlerësimin nëse ato rekomandime po zbatohen. Derisa mos mbajtja e takimeve të rregullta të KA, ndikojnë në mos harmonizimin e veprimeve ndërmjet Kryetarit, NjAB-së dhe departamenteve të audituara në lidhje me çështjet e identifikuara nga auditimi.

**Rekomandimi:** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme për NjAB-në në mënyrë qe planet e auditimit të realizohet në tërësi dhe auditimet të përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Çdo raport i auditimit të brendshëm duhet të pasohet me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe i njëjti të monitorohet në baza të rregullta kohore. Po ashtu KA duhet ti mbajë me rregull takimet në mënyrë që të ofrojë kontributi tij konform obligimeve të përcaktuara me rregullat në fuqi.

Janë marrë për bazë të gjitha rekomandimet e gjetura nga zyra kombëtare e auditimit , ne i kemi adresuar rekomandimet kemi bërë planin e veprimit për adresimin e këtyre të gjeturave , do të angazhohemi në adresimin e të gjeturave për të krijuar një rregullsi për të pasur një prezentim të sakt në të dhënat e RVF 2021 sepse të gjithë akterët (punonjësit ) me të gjaturat e auditorit të jashtëm janë njoftuar do të jenë të përkushtuar që lëshimet e gjetura të mos përsëriten në periudhën e ardhshme raportuese.

Datë 06.09.2022
Viti

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË – OPŠTINA VITINA
KRYETARI KOMUNËS – PREDSEDNIK OPŠTINE